



Pranimi / Dorezimi Primenje / Prizate Receipt / Delivery	10.02.2022	2	viti god year
Organ / Mjesia Organ / Jednica Org / Unit	8 KMSSHCK	647/2022	Sasia Kolicina Quantity
			1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.12/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.12/2022 të datës 11.01.2022, të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit Nr. 0821 të datës 24.12.2021, të Këshillit Shtetërorë për Vlerësim dhe Disiplinë, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 10.02.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.12/2022 të datës 11.01.2022, të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja Ministre e Ministrisë së Ekonomisë, me datë 11.01.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 54/2022, të regjistruar me numër A.nr.12/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.0821 të datës 24.12.2021, të Këshillit Shtetërorë për Vlerësim dhe Disiplinë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. nr. 12/2022, të datës 11.01.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin me numër protokoll 24 të datës 11.01.2022; Vendimin A. Nr. 858/2021 i datës 10.12.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 0821 i datës 24.12.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Vendimin më numër protokoll 0504, i datës 13.08.2021, i Ministrisë të Ministrisë së Punëve të

Brendshme; për pezullimin nga detyra të ankuesit, kërkesën me numër protokollit 01-1971 e datës 30.07.2021 Ministres për Ekonomi, shkresë shtojca 4 me numër protokollit 1593 e datës 12.11.2020, Shkresën-leje për pajisje me vulë 08DL-11, Vendimin me numër protokollit 01/1 i datës 11.12.2020, Vendimin me numër protokollit 01/2 i datës 03.11.2020, Procesverbalin e Komisionit për pajisje me vula i datës 11.12.2020, emali nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ etj., fq.1/2, shkresë 08-DI-08 e datës 17.12.2020, Procesverbalin e datës 23.02.2021 të Komisionit për pajisje me vula, Vendimin me numër protokollit 476, të datës 23.02.2021, të Drejtorit Ekzekutiv i AKEE-së; Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.01/5 i datës 05.04.2021, Autorizim me numër protokollit 01/2021 i datës 03.02.2021, e-maili i datës 26.05.2021 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ email i datës 27.05.2021 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ fq.1/3, kopje e librit të protokollit fq.1/5, Thirrje për aplikim 01/21 e datës 08.02.2021 fq.1/9, Shkresën njoftuese me numër protokollit 48 e datës 06.05.2021; kërkesën/raportim me numër protokollit 1898, i datës 28.07.2021; Raportin përfundimtar i Auditimit me numër protokollit 1613, i datës 15.06.2021, Raportin denoncues - prova shtesë me numër protokollit 1961, i datës 29.07.2021; Raportin përfundimtar i auditimit me numër protokollit 1773; Njoftimin me numër protokollit 363 i datës 10.02.2021; Njoftimin me numër protokollit 362, i datës 10.02.2021; Auditimi i Projektit për Eficencë me numër protokollit 1664 i datës 13.10.2020; Memorandum Mirëkuptimi me numër protokollit 1206 i datës 28.02.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën A.nr.12/2022 të datës 11.01.2022, të parashtruar nga ankuesja

*sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, rezulton se ankuesja \_\_\_\_\_ është e emëruar dhe ushtron detyrën e Ministres së Ministrisë së Ekonomisë në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. E njëjta me datë 11.01.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër 0821 të datës 24.12.2021, të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të procedurës.

Në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 3 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Funksionarë publikë, në kuptimin e nënparagrafit 1.1 të këtij neni, janë: 2.1. të zgjedhurit; 2.2. anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre; 2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura..* Kolegji konstaton se ankuesja në cilësi të anëtares së Kabinetit Qeveritar gjegjësisht Ministres për Ekonomi konsiderohet funksionare publike dhe si rrjedhojë e njëjta nuk ka statusin e nëpunësit civil, kështu që, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses \_\_\_\_\_ A.nr.12/2022 të datës 11.01.2022.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048



për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.12/2022

**Rushit KAJTAZI**

Procesmbajtës



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Udhëheqësit të Këshillit Shtetërorë për Vlerësim dhe Disiplinë ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Ekonomisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

